



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr _____ Prot.

Gramsh, më _____.____.2026

Procesverbal -Tipi i kontrates - Shërbim

(Për argumentimin e kritereve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROÇEDURËS- “Kryerja e shërbimit të pastrimit dhe gjelberimit në qytetin e Gramshit” - Marrëveshje Kuadër - me nje operatorë ekonomike ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 48 muaj.

LLOJI PROÇEDURËS- **“Proçedurë e hapur mbi kufirin e larte monetar–shërbim”**

VLERA TOTALE E FONDIT LIMIT - me **fond limit 197 492 000 (njëqind e nëntëdhjetë e shtate milion e katerqind e nentendhjetë e dy mije) lekë pa TVSH., ose 2 057 208.33Euro,** vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Gramsh për vitet 2026, 2027, 2028 dhe 2029.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Mbjellja e pemëve 77211600-8, Mbjellja dhe shërbimet e mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra 77310000-6, Shërbime të pastrimit 90910000-9

Ne baze te nenit 21, pika 2, te Ligjit nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, te VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, autoriteti kontrator Bashkia Gramsh ka hartuar procesverbalin per argumentimin dhe miratimin e kritereve per kualifikim per proceduren e sipercituar, me permbajtjen si me poshte:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Kriteret (a-b) jane vendosur ne perputhje me Dokumentat e Tenderit te miratuara nga APP bazuar ne Vendimit Nr. 08 Datë 23.09.2024 si dhe bazuar ne Ligjin Nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar.

Pika a) bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Pika b) eshte vendosur ne baze te nenit 30 pika 1 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas **shtojcës 10**

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të leshuara nga administrata tatimore për gjatë tre viteve të fundit, 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 70 % të vlerës së përlogaritur të kontratës.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**"

Argumentimi. Kriteri **2.2.1** është përcaktuar duke u bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe referuar nenit 42 pika 3, nenit 43 pika 2/a, nenit 47 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi. Kriteri është vendosur bazuar në nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, nenit 43, pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, si dhe Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të ketë paguar taksat dhe tarifat vendore për vitin 2025 (këstet e maturuara) për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato**

teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje."

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi:Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar që operatorët ekonomikë nuk kanë pagesa të pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

a) Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën apo kontratat e lidhura me një ent publik të shoqëruar me vërtetime për realizimin me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Kur në faturat tatimore nuk përfshihen të gjitha zërat e shërbimeve, ato duhet të shoqërohen me situacionet ku shënohen datat, **shumat dhe shërbimet e realizuara;**

ose

b) Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat, si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar datat, **shumat dhe shërbimet e realizuara.**

Argumentimi. Kriteri është vendosur bazuar në nenin 77 pika 4 të LPP nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 41 pika 3 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme dhe besueshmërinë për të zbatuar kontratën. Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçensë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) për grumbullim dhe transportim të mbetjeve jo të rrezikshme (Kodi III.2.B) drejtuesi teknik i së cilës të rezultojë në listëpagesat e tij në datën e fundit të hapjes së ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 2, te nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar: ”Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë”, dhe nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, e ndryshuar; **Ligjin Nr. 57, datë 16.10.2025, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”**; Ligji nr. 10 431, date 9.6.2011 ”Per mbrojtjen e mjedisit”; Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”. Licenca e kerkuar me kodin III.2.B eshte ne perputhje me zerat e preventivit te realizimit te sherbimit dhe specifikimet teknike ku kerkohet pastrimi, grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane te klasifikuara si jo te rrezikshme.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet te paraqese Liçensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) “Prodhimi dhe tregëtimi i farave dhe fidanëve” (Kodi II.4).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 2, te nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar: ”Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë”, dhe nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, e ndryshuar; Licenca e kerkuar me kodin II.4 eshte ne perputhje me zerat e preventivit te realizimit te sherbimit dhe specifikimet teknike ku kerkohet mbjellje dhe shërbime të mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te paraqese Liçensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) “Deratizim, dezinfektim, dezinfektim” (Kodi II.8.B).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 2, te nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar: ”Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë”, dhe nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, e ndryshuar; Licenca e kerkuar me kodin II.8.B eshte ne perputhje me zerat e preventivit te realizimit te sherbimit dhe specifikimet teknike ku kerkohet mbjellje dhe shërbime të mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra ku përcaktohen shërbime të desinfektimit.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet te paraqese Liçensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet mjedisore bazë” (Kodi III.7.A).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 2, te nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar: ”Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë”, dhe nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, e ndryshuar; Licenca e kerkuar me kodin III.7.A eshte ne perputhje me zerat e preventivit te realizimit te sherbimit dhe specifikimet teknike ku kerkohet mbjellje dhe shërbime të mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra ku përcaktohen shërbime të desinfektimit. Duke marre ne konsiderate larmishmerine e licencave qe leshohen nga QKL licenca ne fjale eshte me e pershtatshme me e pranueshme dhe me gjithheperfshirese ne perputhje me gamen e sherbimeve qe ne kerkojme te marrim nga OE, si shërbime për drurët ë lartë apo shkurret e bordurat e gjelbra. Bashkia Gramsh eshte nje prej bashkive me siperfaqe te konsiderueshme te gjelberimit ne shkalle vendi dhe pjese e specieve te gjelberimit jane mjaft drure e shkurte te karakterit pyjor si pishe, cedrus, bredh, rrap, murriz, akacie, etj.. Nga ana tjetere, ne "Universitetin Bujqesor te Tiranes", Fakulteti i Shkencave Pyjore eshte ai qe studjon ne menyre te detajuar speciet e mesiperme.

2.3.6- Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

- a) Mjet teknologjik transporti veteshkarkues, per largimin e mbetjeve urbane, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me pak se 10 ton - **1 (një) copë.**
- b) Mjet teknologjik transporti veteshkarkues rezervë, per largimin e mbetjeve urbane, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me pak se 10 ton - **1 (një) copë.**
- c) Mjet teknologjik transporti veteshkarkues, per largimin e mbetjeve urbane, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 3 - 4 ton - **1 (një) copë;**
- d) Mjet transporti me vinç për transportimin e kontenerëve për larje, pemëve, tapetit të barit, etj. me kapacitet mbartës jo më pak se 10 Ton - **1 (një) copë**
- e) Mjet teknologjik autofshesë për fshirjen e rrugëve, te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qëndrore, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, me tub aspirimi të jashtëm thithës 800-1000 kg - **1 (një) copë**
- f) Makina për lagjen e rrugëve, (autobot) me kapacitet mbajtes 9-10 m³ - **1 (një) copë.**
- g) Makineri hidrombjellje për mbjelljen e barit në sipërfaqet e pjerrëta të qytetit me kapacitet 1000-1500 litra - **1 (një) copë.**
- h) Kamioncinë 7 vende të ulura (6+1) dhe kapacitet mbajtes 1- 1,5 Ton për transportimin e punonjësve, mjeteve e pajisjeve të punës,etj. - **1 (një) copë.**
- i) Motorsekë - **2 (dy) copë**
- j) Motosharrë krasitje - **1 (një) copë**
- k) Pompë dezinfektimi spërkatese me pluhur e lëng -**1 (një) copë.**
- l) Korrëse bari tip shkop - **1 (një) copë.**
- m) Korrese bari me rrota - **2 (dy) copë**
- n) Shkallë për krasitje në lartësi - **1 (një) copë.**

Për mjetet e kërkuara operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- a) Mjetet në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar (kontrata shit-blerje ose kontrata dhurimi).
- b) Mjetet me qira duhet të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qerasë duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qera të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekti këti jprokurimi).
- c) Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin si: - leje qarkullimi; - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit; skedat teknike/katalog për të verifikuar kapacitetet e kërkuara nga AK në mungesë të tyre OE ofertues duhet të paraqesë një vetedeklarim ku të shprehen qarte kapacitetet për çdo mjet dhe AK rezervon të drejtën për verifikimin e vetedeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm.
- d) Për mjetet me qira, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij: - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit; skedat teknike/katalog për të verifikuar kapacitetet e kërkuara nga AK në mungesë të tyre OE ofertues duhet të paraqesë një vetedeklarim ku të shprehen qarte kapacitetet për çdo mjet dhe AK rezervon të drejtën për verifikimin e vetedeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit - kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm.
- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- f) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e mjeteve të mësipërme, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektivit të prokurimit. Numri dhe lloji i makinerive dhe paisjeve është vendosur duke ju referuar zerave të shërbimit sipas specifikimeve teknike, sipas grafikut të detajuar dhe kohëzgjatjes së shërbimit, Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin

kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit pergjegjes për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Numri i mjeteve që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në sasinë dhe natyrën e shërbimit. Ky grup bazuar në territorin ku do të shtrihen shërbimet, ka përcaktuar numrin dhe mjetet që duhen për largimin e mbetjeve, fshirjen, freskimin e rrugëve, mbjelljen e drureve e shkurreve, tapetit të barit, pemëve, mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra, etj..

1. Mjet teknologjik transporti veteshkarkues, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton - 1 (një) copë + 1 rezerve. Bazuar në kapacitetin mbartës, sasinë e mbetjeve që do të transportojnë, kapacitetin dhe numrin e kontenierëve që do të perpunohen AK ka llogaritur që për të kryer shërbimin duhet 1 mjet teknologjik transportues me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton, ndërsa 1 mjet duhet rezerve për zëvendësim në rast se është me defekt ndonjë mjet.

2. Mjet teknologjik transporti veteshkarkues, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 3 - 4 ton - 1 (një) copë. Është kërkuar për grumbullimin e mbeturinave në zonat rurale ku nuk ka mundësi të futet mjeti me kapacitet 10 ton. Bazuar në kapacitetin mbartës, sasinë e mbetjeve që do të transportojnë, numrin e rrugëve (104 dite), kapacitetin dhe numrin e kontenierëve që do të perpunohen AK ka llogaritur që për të kryer shërbimin duhet 1 mjet teknologjik transportues me kapacitet mbajtës 3-4 ton.

3. Mjet transporti me vinç për transportimin e kontenierëve për larje, pemëve, tapetit të barit, etj. me kapacitet mbartës jo më pak se 10 Ton - 1 (një) copë. Ky mjet është kërkuar për transportimin e kontenierëve për larje, pemëve, tapetit të barit, etj.. Është kërkuar deri 10 ton pasi pemët e tapeti i barit kanë tonazh më të madh.

5. Makinë për larjen e rrugëve (autobot) për freskimin (lagjen) e rrugëve, me kapacitet mbajtës jo më pak se 9-10 m³ -1 (një) copë. Bazuar në sipërfaqet e planifikuara për freskim (lagje), sasinë e ujit për 1 m², numrin e cikleve (2 here në ditë - 2 ore paradite e 2 ore pasdite), kohën e zbrastjes së autobotit, AK ka llogaritur që për të kryer shërbimin duhet një Autobot me kapacitet mbajtës jo më pak se 9-10 m³.

6. Mjet teknologjik autofshesë për fshirjen e rrugëve, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, me tub aspirimi të jashtëm thithës 800-1000 kg - 1 (një) copë për fshirjen e rrugëve të parashikuara për këtë shërbim ku përfshihen edhe sipërfaqe të rrugëve pedonale në të cilat nuk lejohet të levizin mjete të tonazhit të rëndë (lejohen vetëm mjete shërbimi dhe këmbësorë). AK ka përcaktuar në strukturën e shërbimit të pastrimit edhe fshirjen e disa rrugëve me autofshese.

7. Makineri hidrombjellje për mbjelljen e barit në sipërfaqet e pjerrëta të qytetit me kapacitet 1000-1500 litra - 1 (një) copë. Kjo makineri është kërkuar për të bërë të mundur mbjelljen e sipërfaqeve të pjerrëta të qytetit ku metodologjia e mbjelljes me makineri hidrombjellje është më e përshtatshme për të garantuar një mbjellje as më uniforme që garanton një cilësi të sipërfaqes. Duke pasur parasysh që një makineri me këtë kapacitet mund të realizojë mbjelljen e një sipërfaqe prej rreth 400-500 m² për çdo mbushje AK ka përcaktuar se kapaciteti prej 1000-1500 lt është i përshtatshëm në mënyrë që procesi të mos zgjasë shumë ditë. Nga ana tjetër një kapacitet më i madh i kësaj makinerie do të bënte të vështirë e në disa raste të pamundur që makineria të mund të kishte akses në zona të ngushta ku parashikohen këto punime

duke lejuar në të njëjtën kohë edhe trafikun normal të automjeteve civile të qytëtareve që perdorin rrugët ku mund të punohet.

8. Kamioncinë 7 vende të ulura (6+1) dhe kapacitet mbajtes 1- 1,5 Ton për transportimin e punonjësve, mjeteve e pajisjeve të punës,etj. - 1 (një) copë. Ky mjet është kërkuar për të realizuar transportin e punonjësve,mjeteve e pajisjeve të punës,etj. dhe nisur nga natyra e shërbimeve ku numri i punonjësve është së paku 5-6 persona AK ka përcaktuar numrin e ulëseve të nevojshme. Nga ana tjetër një kapacitet me i madh i këtij mjeti do të bënte të vështirë e në disa raste te pa mundur që të mund të kishtë akses në zona të ngushta ku parashikohen këto punime duke garantuar në të njëjtën kohë edhe trafikun normal të automjeteve civile të qytëtareve që perdorin rrugët ku mund të punohet.

9. Motorsekë - 2 (dy) copë. Bazuar në zërat e preventivave ky kërkohen krasitje të drurëve të lartë shumëvjecarë AK ka përcaktuar dhe konsideruar të nevojshme që OE të disponojë së paku 2 motorresekë.

10. Motosharrë krasitje - 1 (një) copë. Bazuar në zërat e preventivave ky kërkohen krasitje e dhënie forme të shkurreve e bordurave të gjelbra AK ka përcaktuar dhe konsideruar të nevojshme që OE të disponojë së paku 1 motosharrë krasitje

11. Pompë dezinfektimi spërkatese me pluhur e lëng -1 (një) copë – Bazuar në specifikimet teknike e zërat e preventivave ky kërkohen spërkatje të drurëve, desinfektim e klorifikim të tualetit publik apo ambientit rreth kontenierëve të mbeturinave AK ka përcaktuar dhe konsideruar të nevojshme që OE të disponojë së paku 1 pompë dezinfektimi spërkatese me pluhur e lëng.

12. Korrëse bari tip shkop - 1 (një) copë. Bazuar në specifikimet teknike e zërat e preventivave ky kërkohet korrje bari e mirëmbajtje e rrugicave në sipërfaqet e gjelbra ku për arsye se si sipërfaqet e gjelbëruara me bar ashtu edhe rrugicat e gjelbra kufizohen me bordura betoni ku është e pamundur që korrëset me rrota të kryejnë procesin e korrjes AK ka përcaktuar dhe konsideruar të nevojshme që OE të disponojë së paku 1 korrëse bari tip shkop.

13. Korrese bari me rrota - 2 (dy) copë. Bazuar në specifikimet teknike e zërat e preventivave ky kërkohet korrje bari në sipërfaqe të konsiderueshme si dhe me frekuencë të shpeshtë të këtij shërbimi gjatë periudhës me vegjetacion të lartë AK ka përcaktuar dhe konsideruar të nevojshme që OE të disponojë së paku 2 korrëse bari me rrota.

14. Shkallë për krasitje në lartësi - (një) copë. Bazuar në zërat e preventivave ky kërkohen krasitje të drurëve të lartë shumëvjecarë dhe gjithashtu dhënie forma të tyre AK ka përcaktuar dhe konsideruar të nevojshme që OE të disponojë së paku 1 palë shkallë për punime në lartësi.

2.3.5- Nje punësim mesatar prej 30 (tridhjetë) punonjës, në datën e fundit të hapjes se ofertave.

të vërtetuar me;

- Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse,në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhen e kërkuar shoqëruar me formularët e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e fuqise punetore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit.

Argumentimi. Kërkesa është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, gërma c, të VKMnr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të deshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Numri i punonjësve që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në strukturën dhe natyrën e shërbimit. Për këtë qëllim është ngritur edhe grupi i punës, i cili ka hartuar specifikimet teknike dhe ka përlogaritur fondin limit. Ky grup bazuar në territorin ku do të shtrihen shërbimet, në sasinë dhe llojin e tyre (shërbimeve), ka përcaktuar numrin dhe llojin e mjeteve që duhen për largimin e mbetjeve, fshirjen dhe freskimin e rrugëve, shërbimet e gjelberimit, pastrimit të ambienteve në sipërfaqe të gjelbra, etj.. Mbi bazën e kësaj strukture është llogaritur edhe numri i punonjësve për çdo shërbim sipas zerave të preventivit, e konkretisht:

1. AK ka llogaritur minimumi 2 punonjës drejtues mjtesh, bazuar në numrin total të ditëve të punës në vit dhe duke parasysh që një pjesë e shërbimeve si ai i shërbimit të lagjes së rrugëve me autobot apo larja me pompë presioni fillojnë pas muajit maj OE ka mundësi që të sigurojë edhe me vone punonjës të tjerë nëse është e nevojshme. Numri i mjeteve është përcaktuar dhe argumentuar në kriterin 2.3.6.

2. Numri i punonjësve, të cilët do të jenë në dispozicion të mjeteve, duke përjashtuar drejtuesit e mjeteve, do të jetë 6 punonjës, i ndarë si më poshtë:

Numri i punonjësve për mjetin teknologjik 10 ton për largimin e mbetjeve është llogaritur të jetë 2 punonjës, për mjetin teknologjik 3-4 ton dhe lagjen me autobot është llogaritur që numri i punonjësve të jetë 2, për mjetin autofshesë, autovinc dhe kamioncinë është llogaritur që numri i punonjësve të jetë 2 punonjës.

3. Numri i punonjësve, të cilët do të bëjnë fshirjen me krahe të rrugëve, shesheve dhe trotuareve do të jetë 7 punonjës. Nga përlogaritjet norma ditore e fshirjes me krahe është $9971 \text{ m}^2/\text{ditë}$ për një punonjës me frekuencë për çdo ditë. Sipërfaqja ditore e planifikuar për këtë shërbim është rreth 69800 m^2 . Pra duhen 7 punonjës për kryerjen e shërbimit çdo ditë ($69800/9971=7$).

4. Numri i punonjësve, të cilët do të bëjnë fshirjen pjesore të rrugëve dhe trotuareve me frekuencë për çdo ditë do të jetë 4 punonjës. Nga përlogaritjet norma ditore e fshirjes së pjesëshme është $11978 \text{ m}^2/\text{ditë}$ për një punonjës me frekuencë për çdo ditë. Sipërfaqja ditore e planifikuar për këtë shërbim është 47912 m^2 . Pra duhen 4 punonjës për kryerjen e shërbimit çdo ditë ($47912/11978=4$).

5. Numri i punonjësve, të cilët do të bëjnë pastrimin e WC publike me frekuencë çdo ditë të vitit do të jetë 1 punonjës.

6. Numri i punonjësve të shërbimit të mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra, mbjelljeve të reja të drurëve, shkurreve, tapetit të bari, vaditjes me autobot dhe sistemit automatik të vaditjes duke marrë në konsideratë dhe faktin që një pjesë e shërbimeve (korre bari, dhënië forme pemë, shkurre, etj.) kulmojnë në sezona me vegjetacion të lartë ku kërkohej punë intensive në shumë frontë njëherësh si dhe nevoja që për çdo ditë të vitit të ketë shërbim në mirëmbajtje është llogaritur të jetë 7 punonjës.

6. Drejtuesi teknik i shërbimit (përgjegjës) – 1 punonjës

7. Inxhinier i mjedisit ose agromjedisit ose pyjesh ose eksperti në fushën e mjedisit. - 1 punonjës

8. 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”.

2.3.6- Operatori duhet të percaktojë me anë të një deklarate nga Administratori i Shoqërisë, Drejtuesin Teknik (përgjegjës të shërbimit), për të cilin duhet të paraqesë: Kontrate pune, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë në datën e fundit të hapjes së ofertave.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin drejtuesit teknik, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit.

Argumentimi. Kriteri **2.3.6** është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të deklarojnë që kanë stafin teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Drejtuesi Teknik i shërbimit të pastrimit është përgjegjës për zbatimin e këtij shërbimi në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar staf teknik si më poshtë:

- 1 (një) një punonjës të diplomuar në Inxhinier Mjedisë ose Agromjedisë ose Pyjës ose Ekspert të certifikuar në fushën e Mjedisit.

Për punonjësin e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, diploma/certifikata si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit.

Certifikata/diploma/dëshmia duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.SH”, i ndryshuar.

Nuk do të njihen si dëshmi profesionale kurset e trajnimit të lëshuara nga subjektet, të cilat nuk janë të licensuara/akredituara nga institucionet përkatëse për licensimin/akreditimin e tyre.

Argumentimi. Kriteri 2.3.7 është vendosur bazuar në pikën 4, të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenin 41, pika 4, germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të deklarojnë që kanë stafin teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, projektin, relacionet dhe raportet teknike, specifikimet dhe zërat e shërbimit që do të realizohen dhe do të monitorohen në vazhdimësi. Është kërkuar Inxhinier Mjedisë/Agromjedisë ose 1 Ekspert i certifikuar në fushën e Mjedisit nisur nga nga përvoja e mëparshme si dhe legjislacioni për mjedisin. Është vendosur periudha prej 3(tre) muajsh pasi konsiderohet e mjaftueshme që ofertuesi të vërtetojë që ka një vazhdimësi në aktivitetin e përditshëm dhe angazhimin e strukturës së stafit drejtues.

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikatën e vlefshme:

- SSH/EN-ISO 9001 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent
- SSH/EN-ISO 14001 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent

- SSH/EN-ISO 45001 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalent

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, cdo anëtar i ketij bashkimi duhet të dorëzojë çertifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i shërbimit objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtarë, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i shërbimit objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.9 Operatori ekonomik të ketë në stafin e tij:

- 1 (një) punonjes I pajisur me çertifikate “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”.

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë në datën e hapjes së tenderit

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjesit e mesipër do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa është vendosur bazuar në nenin të 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, indryshuar; nenin 41, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; si dhe të ligjit 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njësia e prokurimit gjykon se për mbarëvajtjen e shërbimit, me qëllim garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident si dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni sektorial në fuqi, është e nevojshme prezenca ekspertit për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë. Në nenin 6 të ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë, i ndryshuar parashikohet: ”Detyrime të përgjithshme të punëdhënësve

1. Punëdhënësi, për sigurimin e mbrojtjes së punëmarrësve në të gjitha aspektet, që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë, merr masat e nevojshme nëpërmjet:

- a) parandalimit të rreziqeve për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale;
- b) informimit dhe formimit profesional të punëmarrësve e të përfaqësuesve të tyre;
- c) organizimit të mbrojtjes kolektive dhe individuale;
- ç) sigurimit të organizimit të vendit të punës e të mjeteve të nevojshme.

2. Punëdhënësi kujdeset për përditësimin e masave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duke marrë parasysh ndryshimet e rrethanave, për përmirësimin e situatave ekzistuese.

Në nenin 7 Shërbimet e mbrojtjes dhe të parandalimit, parashikohet:

1. Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion.

2.3.10 Operatori Ekonomik duhet të deklarojë se në rast se shpallet fitues mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruar në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jenë në dispozicion gjatë zbatimit të kontratës dhe nuk do të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve dhe kontenerëve.**

Përsa mesipër, operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë adrese të sakta të vendodhjes së mjeteve që janë në pronësi apo që janë marrë me qira për këtë objekt prokurimi, me qëllim verifikimin e tyre përpara vlerësimit të ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; nenin 41, pika 4, gërma ç, dhe nenin 26 pika 7 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Duke qenë se disponimi i mjeteve dhe pajisjeve behet me deklaram, autoriteti kontraktor ka të drejtën të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vertetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik, prandaj është

kerkuar edhe deklarimi nga ana e operatoreve ekonomike pjesemarrës deklarimi i adresës së vendndodhjes së mjeteve dhe konteniereve.

2.3.11 Operatri ekonomik duhet të deklarojë kontratat e lidhura ose në proces si dhe procedurat në të cilat është shpallur fitues ku të përcaktojë autoritetin kontraktor, objektin e prokurimit, datën, vlerën dhe afatin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; nenit 41, pika 4, gërma ç, dhe nenin 26 pika 7 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që AK të ketë informacion cilët janë AK e tjera që kanë kontratë me OE në mënyrë që t’i kontaktojë ata (AK e tjera) për të verifikuar që stafi teknik si dhe mjetet e pajisjet e deklaruara nga operatori ekonomik nuk janë të angazhuara në kontratat e lidhura apo të shpallura fituese.

Shënim:

1. Kandidati, ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Operatorët e huaj ekonomikë duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën angleze si dhe t’i certifikojnë me vulën “Apostille”. Për vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për “Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj”, duhet të bëhen legalizimet e ketyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. Mosparaqitja e dokumentacionit në këtë formë është kusht s’kualifikues.
2. Në rastin e moslëshimit në vendin e origjinës të dokumentave të kërkuara sipas kriterëve të mësipërme, në rastin e ofertuesve të huaj, do të paraqiten dokumenta të lëshuar sipas legjislacionit të vendit të origjinës ose të paraqiten dokumenta ekuivalente me to ose deklarata me shkrim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Referuar metodologjisë, grupi i punës ka parashikuar dhe vlerësuar këto faktorë të domosdoshëm që lidhen me zbatimin e shërbimit si:

- a. Vendosjen e objektivave për arritjen e një performancë në kryerjen e shërbimeve.
- b. Për përllogaritjen e shpenzimeve të përgjithshme, kemi analizuar çdo element të kostos për çdo proces shërbimi duke i përshtatur ato me kërkesat tekniko – ekonomike

- Operatori ekonomik të garantojë numrin dhe gjëndjen teknike dhe funksionale të mjeteve teknologjike si dhe ato të thjeshta.
- Monitorimin dhe vendosjen e akteve normative për çdo operacion pune në kryerjen e shërbimeve duke përcaktuar qarte detyrimet në zbatim të specifikimeve teknike gjatë kryerjes së tyre.